

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE DATA 18 MAJ 2023

E nderuar Kryetare,

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Të nderuar qytetarë, kudo që gjendeni, Jemi mësuar në proceset zgjedhore edhe me shpifjen, edhe me denigrimin, edhe me gjuhën e urrejtjes, edhe me manipulimin e rezultatit dhe kujtuam se i kishim parë të gjitha, por “sekti” në pushtet na surprizoi sërish, duke provuar që nuk njuh limite. Verbëria e arrogancës i çoi edhe deri në aktin që dëshmon tiraninë, arrestimin e kandidatit rival e më pas fituesin e zgjedhjeve. Kush nuk shkon pas ujërave të komandantit, ndëshkohet. Komuniteti që guxon të krijojë liri do ta paguajë, ndërsa ai që i prin komunitetit, në kërkim të demokracisë, burgoset. Kryetari i zgjedhur i Bashkisë së Himarës, zoti Fredi Beleri, është i burgosur politik, është rrëmbyer nga “sekti i Rilindjes”, është marrë peng nga Kryeministri Edi Rama. Të gjithë atyre, që mund të thonë që mos u nxito, lërja fjalën drejtësisë, unë u them: po, fjalën e ka drejtësia, por ka edhe një logjikë opinionit. Zoti Beleri është arrestuar në flagrancë për dyshime. Kushdo që di shqipen elementare e kupton se këtu kemi absurditetin më të madh. Flagranca presupozon faktin e kryer, ndërsa dyshimi është dyshim. Dhe, për të qenë i drejtë, po ju shpjegoj përse e cilësoj si pengmarrje nga Kryeministri Rama. A e dëgjuat t’u drejtohet drejtpërdrejt qytetarëve duke i kërcënuar se do ta ketë personalisht me ta? Si mund ta ketë një Kryeministër personalisht me disa qytetarë? A nuk ka institucione ky vend? Jo. Këtu çdo gjë është në duart e njëshit. Prandaj, dëshiroj nga ky podium të drejtoj një thirrje të fundit: sot, tani, kreu i Bashkisë së Himarës, zoti Beleri, duhet të shkojë midis komunitetit himarjot, që e zgjodhi të parin e tij. Ata janë njerëz të guximshëm dhe kërkojnë lirinë. Janë njerëz të lirë, prandaj janë edhe të lumtur dhe nuk hezitojnë që për demokracinë të japin leksione.

Së dyti, dua t’i bëj të ditur çdo qytetari të ndershëm të këtij vendi, se, së bashku me zotin Beleri, është marrë peng edhe Pandeli Kokaveshi, në të njëjtat kushte, me të njëjtat akuza absurde, veçse për të kemi një dimension të skajshëm të mungesës së humanizmit: ai është një i ri që ka bërë transplant zemre. Pavarësisht se personalisht kam njoftuar autoritetet më të larta të Policisë së Shtetit dhe të drejtësisë, se qoftë edhe një sekondë më tepër të mbahet, jeta e tij është në rrezik, vazhdojnë ende ta mbajnë peng. Fatkeqësisht, nuk do ta besoni, por mentaliteti policor ka kaluar edhe te disa mjekë; arritje e paprecedentë e Rilindjes. Prandaj, zonja dhe zotërinj, në Himarë, të vjetrit, gjatë të gjithë këtyre ditëve, më kujtonin vitin 1945, kur votuan kundër regjimit, por u syrgjynosën. Atëherë, në krye të atyre që u syrgjynosën ishte Spiro Koleka. Kush ka veshë dëgjon dhe kush ka intuitë kupton, - më tha një i moshuar i mençur, - po të paktën, zoti Dule, këtë herë nuk kemi pushkatime. Së treti, IKMT-ja ka filluar aksione hakmarrëse. Objekti i Dhërmiut 001, dje ishte i rrethuar nga IKMT-ja, buldozerët dhe personeli. Një objekt i legalizuar, një objekt për të cilin shteti shqiptar ka vjelë të gjitha detyrimet e parashikuara në bazë të ligjit. Cili ishte mëkati i zotërisë së moshuar, pronar i këtij objekti? Është e thjeshtë, i biri kishte përmbushur një detyrë ligjore dhe kushtetuese, kishte qenë numëruar në zgjedhjet që zgjodhën fitimtar Fredi Belerin në Bashkinë e Himarës. Ku po e çoni vendin, zotërinj?! Derisa do të vazhdoni ta mbështesni një autokrat, i cili po e fundos përditë edhe më tepër dhe po e zhyt vendin në errësirën e tiranisë?! Faleminderit!

